

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë/ Ambasada amerikane në Prishtinë paralajmëron protesta të mëdha në 16 shtator
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/gjyqi-ndaj-ish-krereve-te-uk-se-ne-hage-ambasada-amerikane-ne-prishtine-p-i104005
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 09:25:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 09:23:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dff26b4b966c2d068ea68a11292005aaa9c7b3416de1a4e2b207e4e1b95ab64a
TEKSTI	5449fe0878b61dfa579a7d9d8cc8165fd07f61fcd9b22578d75e5d0d963aa46a
PAMJA	bc6d5e37271bc8f5d0129138f34a7dafa23b7ce964172b0804071985a075a2e8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bd3a739d402f3aad4a8ba10e669c1944895d1a29834a224d66e9eaca944d983
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bd3a739d402f3aad4a8ba10e669c1944895d1a29834a224d66e9eaca944d983>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **ne Prishtine paralajmëron protesta të mëdha qytetarë për** ■ **se GJKKO për mediat, depoziton** ■ në Gjykatën Kushtetuese kërkesën ■ **regjistruan edhe fëmijë nga** ■ bashkia Vlorë-Himarë ■ **Për sigurinë tuaj nuk bëjmë** ■ dërguar një mesazh urimi për ■ **kercenimin e IA-së ndaj të** ■ shpallur po kërkojnë një ligj të ri për të

KOSOVA

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë/ Ambasada amerikane në Prishtinë paralajmëron protesta të mëdha në 16 shtator

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 11:23



Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë ka paralajmëruar qytetarët për protesta të mëdha që priten të zhvillohen të mërkurën, më 16 shtator, në qendër të Prishtinës dhe në qytete të tjera të mëdha të Kosovës.

Në njoftim, Ambasada amerikane bën të ditur se disa organizata kanë planifikuar demonstrata të mëdha, të cilat mund të shkaktojnë grumbullime të shumta të qytetarëve, mbyllje të rrugëve dhe ndërprerje të konsiderueshme të qarkullimit.

Qytetarëve u është këshilluar që të kufizojnë lëvizjet në zonat pranë vendbanimeve të tyre dhe të shmangin udhëtimet drejt rrugëve, ku priten protestat. Ambasada paralajmëron se personat që do të kalojnë nëpër zonat e prekura mund të përballen me vonesa të mëdha dhe vështirësi për të arritur në destinacion në kohën e planifikuar.

“Këto protesta mund të shkaktojnë turma të mëdha njerëzish, mbyllje rrugësh dhe ndërprerje të rënda të trafikut. Këshillohet të kufizoni udhëtimin në zonën e menjëhershme të banimit tuaj dhe të shmangni udhëtimin për në vendin e punës dhe shkollat nëse rruga juaj kalon nëpër zonat e prekura, pasi mund të mos jeni në gjendje ta përfundoni udhëtimin në kohën e duhur”, thuhet në njoftimin e Ambasadës së SHBA-ve.

Për personelin e Qeverisë amerikane në Kosovë është dhënë udhëzimi që të shmangë të gjitha udhëtimet e panevojshme pranë zonave ku zhvillohen protestat. Për shkak të mundësisë së ndërprerjeve të mëdha në trafik, personeli amerikan është këshilluar gjithashtu që më 16 shtator të mos dërgojë fëmijët në shkollë.

Ambasada amerikane ka njoftuar se do të jetë e hapur të mërkurën, ndërsa shërbimet konsullore do të ofrohen në mënyrë të kufizuar dhe sipas nevojës.

Paralajmërimi vjen në një ditë të ndieshme për Kosovën, pasi më 16 shtator priten të shpallet në Hagë vendimi në procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë proces janë përfshirë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, ndaj të cilëve janë ngritur akuza për krime lufte. Vendimi i shumëpritur ka rritur ndjeshëm interesimin publik dhe vëmendjen në Kosovë.

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 14 Shtator08:32

[Akuza e Hagës për pengim të drejtësisë/ Prokuroria kërkon 6 vite burg për Hashim Thaçin, sot mbahen deklaratat përfundimtare](#)

Procesi gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Hagës ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, si dhe ndaj Bashkim Sm...

KOSOVA 13 Shtator23:39

[LVV dhe LDK me një emër për presidentin, deputeti Kraki: Bashkë i kemi numrat! Ju bëj thirrje...](#)

Deputetit i Lëvizjes Vetëvendosje, Nezir Kraki i ftuar këtë të dielë në emisionin "Review" me Greta Topjana në...

KOSOVA 13 Shtator22:30

[Kurti fton PDK-në të propozojë nënkryetarin e Kuvendit: Të mos humbim kohë me procedura](#)

Kryeministri i sapozgjedhur i Kosovës, Albin Kurti, i ka bërë thirrje Partisë Demokratike të Kosovës që të angazhohet ...

KOSOVA 13 Shtator19:12

["Serbia kreu gjenocid ndaj shqiptarëve"/ Kurti për procesin në Hagë: Asnjë gjykatë nuk e njollos luftën e UÇK](#)

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti duke folur për procesin në Hagë, tha se Serbia ka kryer një gjenocid ndaj shqiptarëve. ...

KOSOVA 13 Shtator16:01

[Albin Kurti u rikthye në krye të ekzekutivit me 62 vota pro, prezantohet kabineti i ri](#)

Kabineti i propozuar nga Kurti: Zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës- Glauk Konju...

KOSOVA 13 Shtator15:21

["Asnjë gjykatë s'mund ta njollosë UÇK-në" Kurti: Jemi në ankth në prag të vendimit në Hagë](#)

Mandatari për formimin e qeverisë së re të Kosovës, Albin Kurti e nisi fjalën e tij në seancën e jashtëzakonshme pë...

KOSOVA 13 Shtator15:01

[U zgjodh nënkryetare/ Deklarata e deputetes serbe: Kosova arreston fëmijët tanë padrejtësisht! Po vuajmë më keq se në kohën e Perandorisë Osmane](#)

Deputetja serbe Tanja Vujović u zgjodh nënkryetare e Kuvendit të Kosovës. Ajo mori edhe votat e deputetëve të Lëvizjes Vetë...

KOSOVA 13 Shtator13:27

[Albulena Haxhiu e dekreton Albin Kurtin për kryeministër](#)

Presidentja në detyrë e Kosovës, Albulena Haxhiu, ka mandatuar Albin Kurtin për formimin e Qeverisë së re të Republikës ...

KOSOVA 13 Shtator13:04

[Konstituimi i Kuvendit të Kosovës me zgjedhjen e nënkryetarëve, Kurti: Votojmë Vlora Çitakun, kur PDK-ja të kthehet në seancë](#)

Ndërsa kryeparlamentarja Albulena Haxhiu, e cilësoi "të konstituuar" legjislaturën e 11-të të Kuvendit të Kosovës...

KOSOVA 13 Shtator11:39

[Nga Ardian Gola te Emilija Rexhepi, kush janë 4 nënkryetarët e rinj të Kuvendit të Kosovës](#)

Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur katër nga pesë nënkryetarët e legjislativit, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës ka mbetur pa p...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

[“Dil jashtë”, u përplas me Edi Ramën për “Terri...](#)

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

AKTUALITET 13 Shtator

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...](#)


Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Deklarata e Gjestit!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.